

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mr.sc. Muhamet Rexha, kryetar, Gyltene Sylejmani dhe Erdogan Haxhibeqiri, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit Q.B., nga Prishtina, të cilin e përfaqëson avokati B.A., po nga Prishtina, kundër të paditurës Ministria e Rinisë dhe Sportit Prishtinë -T.K.P., përfaqësuar nga Ministria e Drejtësisë -Divizioni për Përfaqësime Gjyqësore Prishtinë, për kompensim të asistencës-ndihmës (të ardhurave personale), përkitazi me revizionin e paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.1034/2013, datë 11.12.2015, në seancën e mbajtur më 17.03.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Pranohet si i themeltë revizioni i paditësit dhe NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Prishtinë, Ac.nr.1034/2013, datë 11.12.2015, ashtu që refuzohet si e pabazuar ankesa e së paditurës, kurse aktgjykimi i Gjykatës Komunale Prishtinë, C.nr.1441/09, datë 16.10.2012, lihet në fuqi.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.1034/2013, datë 11.12.2015, është aprovuar ankesa e së paditurës dhe është ndryshuar aktgjykimi i Gjykatës Komunale Prishtinë, C.nr.1441/09, datë 16.12.2012, ashtu që është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura t'ia kompensojë asistencën (të ardhurat personale) sipas shkresës nr... datë.... dhe atë për muajin tetor 2003 shumën prej 96€; për periudhën nga 1.01.2004 deri në datën 31.08.2010 nga 105 € në muaj ose shumën e përgjithshme prej 8400€; për periudhën prej 1.09.2010 deri më 31.12.2010 nga 105 € në muaj ose shumën e përgjithshme prej 420 €; për periudhën prej 01.01.2011 deri më 15.03.2011 nga

119 € në muaj ose shumën e përgjithshme prej 1725,50€, përkatësisht pagesën në total prej 10.641,50 €, me kamatë ligjore duke filluar nga data 21.01.2004 deri në pagesën përfundimtare, kurse nga data 16.03.2012 e tutje, derisa të ekzistojnë kushtet ligjore të parashikuara në shkresën nr... dt..., t'i paguajë për çdo muaj, deri në datën të muajit vijues, nga 119 € si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 623€, në afat prej 7 ditësh, nga ditë që aktgjykimi të marrë formë të prerë, me kërcënim të përmbarrimit të detyruar.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së shkallës së dytë, paditësi ka paraqitur revizion brenda afatit ligjor, për shkak të shkeljeve të esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që revizioni të pranohet, aktgjykimi i goditur të ndryshohet dhe ankesa e të paditurës të refuzohet, kurse aktgjykimi i shkallës së parë të vërtetohet ose aktgjykimi i goditur të priset dhe lënda të kthehet për rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur në pajtim me nenin 215 të LPK, konstatoi:

Revizioni i paditësit është i themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, më 28.01.2004, ka ngritur padi në gjykatën kompetente kundër të paditurës, për kompensimin e asistencës si në petium të padisë, përkatësisht si në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë. Paditësi tek e paditura (në TKP) ka qenë në marrëdhënie pune nga viti 1981, në vendin e punës referent i marrëdhënies së punës, se, siç rrjedh nga shkresa nr... datë.... të lëshuar nga e paditura, prej vitit 2000 ai është paguar prej saj me shumën prej 70% të mesatares së pagës të realizuar në tre muajt e fundit, gjë që dëshmohet edhe nga vërtetimi i shërbimit financiar të së paditurës, datë 8.06.2004. Pra, e paditura, me shkresën nr... dt... dhe me vendimin nr... dt..., e ka njoftuar paditësin se, duke filluar nga data 1.09.2000 nuk do t'i vazhdohet kontrata e punës, ashtu që ajo obligohet që të paguajë 70% nga mesatarja e pagës që ka realizuar tre muajt e fundit. Në këtë shkresë ka vënë në dukje se pagesa do të zgjasë derisa të formohet Fondi për pensionim të rregullt të parakohshëm apo invalidor, përkatësisht derisa të formohet Fondi për sigurimin material të tregut për punësim. Ndërkaq, me vendimin nr.... datë ..., paditësit ia ka ndërprerë pagesën e asistencës, duke filluar nga data 1.01.2004, me arsyetimin se nga viti 2002 në Kosovë janë themeluar dhe veprojnë organet kompetente që mbulojnë fushat e sipërpërmendura. Nga ekspertiza financiare e

ekspertit gjyqësor financiar, A.G., datë 3.08.2010 dhe plotësimi i saj datë 14.03.2012, është caktuar shuma e kompensimit për periudhën kontestuese.

Në bazë të kësaj gjendjeje faktike të vërtetuar, gjykata e shkallës së parë e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Gjykata e shkallës së dytë, duke vepruar në procedurën ankimore, e ka aprovuar ankesën e së paditurës dhe e ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë, ashtu që e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, duke vlerësuar se e paditura e ka përmbushur obligimin ndaj paditësit, të cilin ka qenë e detyruar ta paguante deri në formimin e organeve për punësim, ndihmë sociale dhe pensionim.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendja e këtuilë e çështjes, ka vlerësuar se gjykata e shkallës së dytë e ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar. Fillimisht, gjykata e shkallës së dytë e ka zbatuar gabimisht dispozitën e nenit 11.1 p. b/ të Rregullores së UNMIK nr.2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë, sepse kjo dispozitë nuk ka të bëjë me rastin konkret (kontesti nuk ka të bëjë me shkëputje të kontratës së punës) dhe se kjo rregullore ka hyrë në fuqi në datën 8.10.2001, ndërkohë që vendimi dhe shkresa e sipërpërmendur e së paditurës janë të datës 5.10.2000, kur kjo rregullore nuk ishte në fuqi.

Gjykata Supreme e Kosovës, i ka vlerësuar si të themelta thëniet në revizion që kanë të bëjnë me shkeljet e dispozitave të LPK dhe me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale edhe për faktin se Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor nuk është funksional. Rregullorja e UNMIK-ut 2003/40 për shpalljen e Ligjit nr.2003/23 për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë, i cili rregullon rastet e personave me paaftësi të përhershme, të cilët mund ta gëzojnë këtë skemë në pajtim me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë ligj, por nuk e rregullon themelimin e sigurimeve pensionale dhe invalidore të vendit. Themelimi i Fondit të Sigurimeve Pensionale dhe Invalidore në Republikën e Kosovës përcaktohet me Ligjin për Pensionin Invalidor, i cili është në proces të hartimit dhe miratimit në organin kompetent. Sipas Ligjit për Pensionet e Personave me aftësi të kufizuar, përfitues të tij janë të gjithë personat me aftësi të kufizuar të përhershme dhe të plotë (shuma 45 €) si dhe pensionet e kontribut-dhënësve (82€) që rregullohen me vendim të Qeverisë, përfitues të të cilit janë të gjithë pensionistët që kanë arritur moshën e pensionit prej 65 vjeç dhe të cilët kanë 15 vjet përvojë pune.

Duke marrë për bazë faktin se themelimi i Fondit të Sigurimeve Pensionale dhe Invalidore në Republikën e Kosovës përcaktohet me Ligjin mbi Pensionin Invalidor, i cili është në proces të hartimit dhe miratimit të Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se ende qëndron detyrimi i së paditurës që ndaj paditësit ta përmbushë obligimin sipas vendimit të saj nr... datë ... përderisa të mos jetë themeluar dhe funksionalizuar Fondi i sipërpërmendur, përkatësisht derisa paditësi ta arrijë moshën e pensionit të pleqërisë-moshën 65 vjeç.

Për arsyet e sipërpërmendura, Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se gjykatat e shkallës së dytë e ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale, prandaj e ndryshojë aktgjykimin e saj dhe vendosi ta lërë në fuqi aktgjykimin e shkallës së parë.

Nga sa u parashtrua dhe në mbështetje të dispozitës së nenit 224.1 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Rev.nr.56/2016 datë 17. 03. 2016

Kryetari kolegjit

Mr.sc.Muhamet Rexha